



Instituti i Sociologjisë - IS
Albanian Institute of Sociology - AIS
Rr. Abdyl Frashëri, Pall. 3/3,
Tiranë
Tel & fax: ++ 355 (4) 268 819;
Mobile: ++ 355 (0) 692032731;
E-mail: lsokoli@institut-i-sociologjise.org
Web site: www.institut-i-sociologjise.org

STATUTI I INSTITUTIT TË SOCIOLOGJISË

Një grup nismëtarësh, sociologë e studiues socialë - autorë të krijimtarisë sociologjike - anëtarë të Institutit të Studimeve Politike e Sociale (ISPS), bashkëpunëtorë shkencorë të tij e të revistës shkencore “Politika & Shoqëria”, si dhe studiues të tjerë të interesuar për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe të veprimtarisë sociologjike në Shqipëri, ranë dakord për krijimin e Shoqatës Sociologjike me emrin Instituti i Sociologjisë, i cili do të jetë organizatë joqeveritare e jofitimprurëse me anëtarësi. Veprimtaria e tij do të bazohet në këtë statut.

KREU I Dispozita të përgjithshme

Neni 1 Emërtimi

Shoqata sociologjike emërtohet Instituti i Sociologjisë. Në vijim të këtij statuti ai do të quhet, në formë të shkurtuar, IS.

Në marrëdhëniet me institucione, shoqata dhe OJF të huaja, IS do të njihet me emrin, në anglisht, “Albanian Institute of Sociology”, në trajtë të shkurtuar AIS.

IS bazohet në traditën më të mirë të organizimit të institucioneve të sociologjisë, sidomos në përvojën e ISPS dhe organit të saj “Politika & Shoqëria”, revistë e shkencave politike e sociale. Ai trashëgon krijimtarinë sociologjike të derisotme dhe kontributet e individëve, drejtues dhe bashkëpunëtorë të ISPS dhe organit të tij shkencor.

Neni 2 Karakteri dhe parimet udhëheqëse

IS krijohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (ligji 7850, datë 29. 07. 1994), si dhe me ndryshimet e bëra me ligjin Nr. 8781, datë 3. 05. 2001 dhe ligjin “Për Organizatat Jofitimprurëse”, Nr. 8788, datë 7. 05. 2001.

IS është pjesë e shoqërisë civile shqiptare. Ai është i pavarur nga administrata publike, institucionet shtetërore, politike apo fetare, qofshin këto shqiptare apo të huaja. Veprimtaria e IS nuk ndjek qëllim ekonomik.

Parimet udhëheqëse të IS janë: **puna në grup, anëtarësia, gjithëpërfshirja, vendimarrja kolegjiale, hierarkia e vlerave shkencore** dhe e **kontributeve të tjera**

(materiale, financiare etj.) të domosdoshme për zhvillimin e kërkimit shkencor sociologjik, **transparenca e veprimtarisë** dhe **komunikimi i hapur** (kryesisht në rrjet) midis anëtarëve. Në punën e vet hulumtuese, në kuadrin e IS, anëtarët e tij i përmbahen **parimit të rigorozitetit shkencor** akademik.

Neni 3 **Qëllimi i IS**

Të nxisë zhvillimin e sociologjisë teorike, kritike, të aplikuar, empirike, të politikave, sociologjisë publike etj. si dhe të disiplinave të veçanta të saj, siç janë: sociologjia politike, sociologjia e kulturës dhe artit, e familjes, sociologjia urbane apo rurale, ajo e punës dhe e profesionit, e edukimit, socioekonomia etj., etj.

Të kordinojë dhe stimulojë veprimtarinë shkencore të studiuesve të kësaj fushe, të nxisë kërkimin dhe debatin shkencor akademik.

Të sensibilizojë opinionin publik shqiptar dhe institucionet e tjera të shtetit dhe shoqërisë për dukuri të ndryshme sociale dhe të sugjerojë rrugëzgjdhje me interes publik.

Të bëhet burim inkurajimi për studiuesit e sociologjisë, sidomos për studiuesit e rinj. Të stimulojë krijimin e hierarkisë së vlerave dhe kontributeve, shkencore si dhe të sponsorizimit të kërkimit shkencor sociologjik.

Të bëhet një institucion me autoritet shkencor dhe i besueshëm në testimin e opinionit publik, duke iu përmbajtur rigorozitetit shkencor dhe duke aplikuar një metodologjie rigorozë të hulumtimit sociologjike.

Të synojë organizimin e sondazheve të natyrave të ndryshme, si sondazhet paraelektorale apo sondazhe të testimit të perceptimit qytetar për probleme të ndryshme sociale.

Të krijojë një rrjet të kërkimit shkencor sociologjik në Shqipëri dhe ndër studiuesit shqiptarë pavarësisht ku punojnë e jetojnë, duke synuar përfshirjen e të gjithë studiuesve të sociologjisë, apo studiuesve potencialë, pa dallim bindjesh personale, përkatësish partiake, gjinore, fetare, etnike etj.

Të krijojë mundësi financimi të kërkimit shkencor sociologjik, përmes vullnetarizmit të anëtarëve dhe miqve të sociologjisë, sponsorizimeve, botimeve, shërbimeve, sipërmarrjes mbi baza ligjore, projekteve të financuara etj.

Të ndjekë dhe evidencojë krijimtarinë sociologjike të studiuesve shqiptarë dhe bashkëpunëtorëve të tyre të huaj, si dhe t'a publikojë atë përmes botimesh, internetit e në forma të tjera.

Të ndjekë dhe të nxisë përgatitjen e kuadrove të rinj të sociologjisë, përgatitjen e tyre në universitetet publike e jopublike, punësimin e tyre, kualifikimin shkencor pasuniversitar, përfshirjen në projekte etj.

Të organizojë, nxisë apo të marrë pjesë përkrah subjekteve të tjera të shoqërisë, veprimtari në të mirë dhe interes të publikut, duke kuptuar me këtë veprimtari që mbështet dhe zhvillon tek individit dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së IS

Objekti i veprimtarisë së IS përfshin, sidomos këta elementë: studim-zbulim-botim, komunikim-debatim, gjithëpërfshirje-integrimi, zbatim-konkretizim, mësim-trainim-edukim.

Më konkretisht, objekti i IS përfshin:

Studime shkencore në fushën e sociologjisë;

Veprimtari shkencore (simpoziume, seminare, konferenca, tryeza diskutimesh etj.), me tematikë sociologjike;

Leksione akademike e publike, mbi problemet sociale të shoqërisë;

Kurse afatshkurtëra e afatmesme trainimi për përgatitje profesionale e shkencore;

Bashkëpunim shkencor me universitete publike e jopublike, organizata, shoqata dhe institucione shqiptare e të huaja;

Anëtarësim në institucionet shkencore sociologjike ndërkombëtare;

Botime librash, revistash etj., me karakter shkencor sociologjik, kryesisht sociologjik apo të shkencave të afërta me sociologjinë;

Veprimtari ekonomike ose joekonomike (për shëmbull, organizimi i fushatave për fonde, grante, donacione) e çdo lloj veprimtarie tjetër të ligjshme që gjeneron të ardhura, me kusht që të ardhurat ose pasuritë e IS të përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë statut.

Neni 5

Organi shkencor i IS

IS ka organin e vet shkencor, të vaçantë ose të përbashkët me institucione homologe. Kriteret e botimit të organit shkencor të IS përputhen me kriteret për përfshirjen në listën e periodikëve shkencorë, që merren në konsideratë nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Emri, periodiciteti, tirazhi, redaksia (bordi botues apo edhe këshillimor) etj., i organit të IS vendosen dhe ndryshohen nga strukturat vendimmarrëse të tij dhe, në rastet e bashkëbotimeve, në marrëveshje me institucionet homologe.

Neni 6

Selia dhe shtrirja

IS ka selinë e vet në Tiranë, në adresën: Rruga “Abdyl Frashëri”, pall. 3/3. Adresa ndryshon, në vertësi të rrethanave. Për këtë vendosin strukturat vendimmarrëse të tij.

IS ka degët e saj në rethe të ndryshme të vendit ose edhe jashtë Shqipërisë të emëtuara degë ose bërthama shkencore sociologjike.

Neni 6

Juridiksioni

IS është organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit “Për Organizatat Jofitimprurëse”, nr. 8788, datë 7.5.2001. Numri minimal i anëtarëve themelues duhet të jetë 21 (njëzetënjë). Ky konsiderohet edhe numri minimal i funksionimit si e tillë. Ku nuk arrihet numri minimal prej 21 anëtarësh, parashkikohet shpërndarja e IS ose

shndërrimi i tij në OJF pa anëtarësi (si qendër e studimeve sociologjike), në rast se numri i anëtarëve është mbi pesë.

IS fiton cilësinë e personit juridik, nga data e regjistrimit në gjykatë.

Neni 7 Kohëzgjatja e IS

Parashikohet që veprimtaria e IS të zgjasë dhjetë vjet, nga dita e regjistrimit në gjykatë. Pas këtij afati kërkohet reregjistrimi ose, në mungesë të vullnetit të anëtarëve, shpërndarja, siç është parashikuar në nenet vijuese të këtij statuti.

Neni 8 Transferimi, bashkimi, ndërprerja e veprimtarisë

Qendra e IS nuk mund të transferohet jashtë kryeqytetit por, sipas mundësisë, krijon degët e saj kudo ku e gjykon të arsyeshme, brenda e jashtë Shqipërisë.

IS mund të bashkohet me institucione të tjera të shoqërisë civile që kanë fusha të afërta veprimtarie, ose mund të integrohet në institucione të tjera akademike publike, nëse për këtë vendos organi vendimmarrës i tij.

Shpërndarja ose ndërprerja e veprimtarisë ndosh kur IS falimenton (humb aftësinë për të mbijetuar e për të realizuar qëllimet e saj), kur ka konfliktet të pazgjidhëshme interesash, kur nuk arrin numrin minimal të anëtarëve ose me vendim të gjykatës, sipas nenit 44 të ligjit "Për OJF-të" (Nr. 8788, dt. 7.05.2001). Në këto raste shpërbërja bëhet mbi bazën e procedurave ligjore.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I IS

Neni 9 Organet vendimmarrëse dhe administrative

Organi më i lartë vendimmarrës i IS është Asambleja (mbledhja e përgjithshme e anëtarëve) të tij. Ky organ mblidhet jo më pak se një herë në vit.

Organi më i lartë shkencor i IS është Bordi Akademik i tij, ndërsa organi më i lartë ekzekutiv është Bordi Ekzekutiv ose, në mungesë të tij, Drejtori Ekzekutiv.

Neni 10 Organi më të lartë vendimmarrës i IS

Organi më i lartë drejtues i organizatës është mbledhja e përgjithshme ose asambleja e të gjithë anëtarëve të saj. Të gjitha organet e tjera drejtuese zgjidhen ose emrohen, por gjithnjë përgjigjen përpara organit më të lartë të IS.

Anëtar i IS mund të jetë çdo sociolog, studiues i sociologjisë, i diplomuar për sociologji ose i diplomuar në degë të tjera por që ka krijimtari të vlerësuar si krijimtari sociologjike e që pranon statutin e IS. Aplikimi për pranim në IS bëhet individualisht. Aplikanti fiton statusin e të qenit anëtar i IS-së nga dita kur miratohet në Bordin Akademik. Me këtë rast ai merr çertifikatën e anëtarësisë në IS.

Organi më i lartë vendimmarrës i IS mblidhet me pjesmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij dhe vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm. Vendimet për ndryshimin e statutit merren me 2/3 e anëtarëve të IS. Vendimet mund të merren edhe me votim në rrjet, përmes internetit. Por votimet për individët drejtues bëhen gjithnjë të fshehta dhe vetëm me kuti.

Asambleja e IS mund të krijojë organizma të tjerë vendimmarrës, ekzekutivë ose këshillimorë, si kur e lejon statuti ashtu edhe kur statuti nuk e pengon shprehimisht.

Asambleja vendos për ndryshimin e statutit të IS. Ajo përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë së tij, mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre, shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit, miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e IS, shpenzimet etj., Asambleja nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës.

Asambleja zgjedh anëtarët e Bordit Akademik të IS, që është organi më i lartë shkencor i tij.

Asambleja e IS përcakton kriteret e emërimit për individët që përbëjnë Bordin Ekzekutiv, që është organi më i lartë ekzekutiv i IS.

Asambleja mund të krijojë grupe të përkohshme monitorimi, komisione apo instrumenta të tjerë në funksion të veprimtarisë së IS.

Asambleja e përcakton masën e kuotizacionit të anëtarësisë dhe miarton Kodin e Etikës së IS.

Neni 11

Organi më i lartë shkencor i IS

Organi më i lartë shkencor i IS është Bordi Akademik, i cili është organi më i lartë vendimmarrës, midis dy asambleve të IS.

Numri i anëtarëve të Bordit Akademik mund të variojë nga pesë deri në nëntë, në varësi të numrit të anëtarëve të organizatës dhe të kriterëve të përzgjedhjes, lidhur me gradat dhe titujt shkencorë.

Bordi Akademik mblidhet me pjesmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij dhe vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Bordi Akademik zgjidhet nga asambleja, në fund të çdo viti akademik. Mbledhja e asamblesë përkon, si rregull, me Konferencën Kombëtare vjetore të Studimeve Sociologjike.

Bordi Akademik, si rregull, mblidhet jo më pak se një herë në muaj. Ai thirret nga kryetari i tij, ose nga drejtori ekzekutiv i IS.

Bordi Akademik ka mandat njëvjeçar. Ai zgjidhet me votim të fshehtë (me kuti), në mbledhjen vjetore (asamblenë) e IS. Vetë Bordi Akademik zgjedh, me votim të fshehtë (me kuti), kryetarin dhe zëvendësin e tij.

Anëtar i Bordit Akademik mund të jetë çdo anëtar i IS. Jo më pak se 70 për qind e anëtarëve të Bordit Akademik duhet të kenë gradën shkencore “Doktor i Shkencave”.

Bordi Akademik ripërtërit me të paktën një të tretën e anëtarëve të tij, në çdo rast zgjedhjesh, kur kjo mundësohet nga anëtarët me tituj e grada shkencore.

I njëjti person nuk mund të zgjidhet kryetar i Bordit Akademik, ose zëvendës i tij, më shumë se dy herë radhazi.

Kryetari i Bordit Akademik është autoriteti më i lartë shkencor i IS. Ai, ose zëvendësi i tij, drejtojnë mbledhjet e Bordit Akademik, si dhe të Asamblesë së IS.

Drejtori ekzekutiv i IS dhe kryeredaktori i organit shkencor të tij, marrin pjesë në mbledhjen e Bordit Akademik, por pa të drejtë vote.

Bordi Akademik shpall dhe ndjek zbatimin e synimeve të një viti akademik, për anën shkencore, apo të një viti kalendarik, për anën financiare.

Bordi Akademik vendos procedurat e aplikimeve për projekte të financuara nga individë, sipërmarrje private, organizata vendore e ndërkombëtare e donatorë të tjerë të ligjshëm.

Bordi Akademik vendos rregullat e delegimit dhe të përfaqësimit të anëtarëve të IS në veprimtari të tjera, kombëtare e ndërkombëtare.

Anëtarët e Bordit Akademik, si rregull, ushtrojnë funksionin e tyre pa shpërblim. Në këto raste kontributi i tyre vlerësohet, sipas sistemit të krediteve.

IS, në respektim të parimit të interesit më të mirë të tij, në varësi të kushteve të tij, të numrit dhe të kohëzgjatjes së mbledhjeve apo aktiviteteve të tjera, mund të rimbursojë të ardhura dhe të shpërblejë, në mënyrë të arsyeshme, anëtarët e organit më të lartë drejtues, për pjesëmarrjen në mbledhjet dhe aktivitetet e tij.

Bordi Akademik shqyrton aplikimet për anëtarësim në IS, thërret mbledhjen e asamblesë; udhëheq përgatitjen e materialeve dhe vendimeve (projekt) të saj, si dhe të konferencës vjetore të studimeve sociologjike; harton dhe miraton metodologjinë e vlerësimit të kontributeve të anëtarëve, bazuar në krijimtarinë e tyre shkencore dhe në ndihmesën materiale apo financiare; shqyrton krijimtarinë sociologjike të anëtarëve dhe ka atributin e vlerësimit dhe të kualifikimit “vepër shkencore sociologjike” (libër, artikull, referat në konferenca kombëtare e ndërkombëtare etj.), të tillë që mund të vlerësohet si kontribut; miraton materialet që do të botohen në organin shkencor të IS etj.

Neni 12 **Organi më i lartë ekzekutiv i IS**

Organi më i lartë ekzekutiv i IS është Bordi Ekzekutiv. Ai përbëhet nga individë të punësuar pranë IS. Bordi Ekzekutiv drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv. Kur nuk sigurohet Bordi Ekzekutiv, autoriteti më i lartë ekzekutiv është Drejtori Ekzekutiv.

Pranë Bordit (drejtorit) Ekzekutiv, punojnë edhe drejtuesi i botimeve, financës, infomatikës, drejtuesit e projekteve etj.

Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi i IS kundrejt institucioneve të tjera dhe personi i kontaktit të IS.

Drejtori Ekzekutiv emërohet nga pesë kontribuesit kryesorë, anëtarë të IS, sipas vendit që zenë në hierarkinë e kontributeve, të vlerësuar me sistem kreditesh, të vendosur nga Bordi Akademik. Drejtori ekzekutiv emrohet me një mandar tre vjeçar. Për mandatin e parë ai emrohet nga mbledhja themeluese e IS.

Në veprimtarinë e IS zbatohet parimi “një anëtar, një funksion”.

Organi vendimmarrës dhe ai ekzekutiv janë, pak a shumë, në raportin forume-administratë. Siç parashikohet në nenin 22 të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”, veprimtaria e përditshme dhe ekzekutimi i programeve të vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës (Asambleja e IS dhe, midis dy asambleve, nga ordi Akademik), bëhet nga organi më i lartë ekzekutiv individual (Drejtori Ekzekutiv) ose kolegjial (Bordi Ekzekutiv), kur krijohen mundësitë.

Punonjësit e paguar nuk mund të jenë anëtarë të organit vendimmarrës të IS. Ata mund të marrin pjesë në mbledhjet e tyre, por pa të drejtë vote.

Rregullat e veprimtarisë së organit ekzekutiv dhe detyra të tjera të tij, veç atyre të parashkuara në këtë statut, caktohen nga organi vendimmarrës.

Organi ekzekutiv bazohet në parimin e vullnetarizmit (gjithnjë me vlerësim të kontributeve) dhe në shpërblimin (pagën). Anëtari ose anëtarët e organit ekzekutiv dhe punonjësit, me kohë të plotë ose part time të IS, për punën e kryer përfitojnë pagë, shpërblime dhe rimbursim për shpenzimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave të tyre (sipas nenit 23 të ligjit Nr. 8788, datë 7. 05. 2001).

Bordi/Drejtori Ekzekutiv, kanë të drejtën e bllokimit të përkohshëm të vendimeve të organeve vendimmarrëse të IS, nëse konstatohen manipulime, konflikte interesash, politizime apo devijime nga programi i tij. Në këto raste fillojnë konsultimet për rigjetjen e konsensusit ose pritet që për to të shprehet gjykata.

Neni 13

Përgjegjësia e anëtarëve të organeve drejtuese dhe punonjësve të IS

Anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive, si dhe punonjësit e IS nuk përgjigjen për detyrimet e saj ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, i kanë shkaktuar dëm të tretëve.

Neni 14

Të drejtat e anëtarëve të organizatës IS

Çdo anëtar i IS ka të drejtë:

Të marrë pjesë në veprimtarinë e IS, të zgjedhë dhe të zgjidhet në forumet e tij, në përputhje me kriteret e vendosura shprehimisht në këtë statut.

Të aplikojë për projekte në emër të IS dhe të drejtojë, si kordinator apo edhe drejtues, projektet në përputhje me objektivat e tij dhe parimin e transperencës së veprimtarisë, sipas procedurave të aplikimeve për projekte të financuara, që ka vendosur Bordi Akademik.

Të monitorojë gjithë veprimtarinë shkencore, ekonomike e financiare të IS, të marrë, në çdo kohë, informacionin e duhur për gjithçka bëhet në kuadrin e organizatës.

Të përfaqësojë organizatën në veprimtari të tjera, kombëtare e ndërkombëtare, duke respektuar rregullat e delegimit dhe të informimit, të vendosura nga Bordi Akademik..

Të kërkojë vlerësimin e kontributeve vullnetare në organizatë si dhe pagën për punën e kryer në kuadrin e projekteve të financuara drejtpërsdrejti, apo edhe për detyra të tjera, në përputhje me funksionet dhe aftësinë paguese të organizatës.

Të drejta të tjera parashikohen në pjesët e tjera të këtij statuti.

Neni 15

Detyrat e anëtarëve të organizatës AIS

Të pranojë statutin e IS dhe të punojë për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të tij. Të marrë pjesë në mbledhjet e anëtarësisë dhe të ndihmojë në zgjedhjen e elementëve më përfaqësues në organet vendimmarrëse.

Të zgjedhë dhe të zgjidhet në forumet e tij, në përputhje me kriteret e vendosura shprehimisht në këtë statut.

Të aplikojë për projekte në emër të IS dhe të drejtojë, si kordinator apo edhe drejtues, projektet në përputhje me objektivat e tij, transperencën e veprimtarisë dhe rregullat financiare, sipas procedurave të vendosura nga Bordi Akademik.

Në të gjithë veprimtarinë e tij anëtari i organizatës ka për detyrë të punojë për ngritjen e imazhit dhe autoritetit shkencor e publik të IS, sidomos në marrëdhëniet me donatorët dhe opinionin publik. Pas çdo projekti të drejtuar prej tij, në emër të organizatës, IS duhet të jetë më e vlerësuar se më parë.

Çdo anëtar ka detyrë të denoncojë, brenda organizatës apo në raste ekstreme edhe në gjykatë, çdo shkelje që konstaton, të kryer nga çdo anëtar i IS apo organ drejtues i tij,

Të paguajë kuotizacionin e anëtarësisë.

Të zbatojë detyrat që parashikohen në pjesët e tjera të këti statuti.

Neni 16

“Anëtarë Korespondentë” dhe “Anëtarë Nderi” të IS

IS, veç anëtarëve të tij me të drejtat dhe detyrat e parashikuara më sipër, mund të ketë edhe “Anëtarë korespondentë” dhe “Anëtarë Nderi”.

Anëtarë korespondentë të IS mund të jenë studiues me të njëjtat cilësi sikurse anëtarët e tjerë të tij, por që nuk jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk bëjnë pjesë në degët ose bërthamat shkencore të tij.

Anëtarë nderi të IS mund të jenë individë, shqiptarë ose të huaj, me kontribute shumë të veçanta shkencore në fushën e kërkimit sociologjik, me një veprimtari të gjatë shkencore e botuese, sikurse individë jo të fushës, por që janë miq të sociologjisë e që financojnë në masë të konsiderueshme IS-në.

Kriteret e cilësimit “Anëtar Nderi” dhe “Anëtar Korespondent” përcaktohen nga Bordi Akademik, i cili vendos edhe pranimin për këtë kategori individësh, duke gjykuar rast pas rasti.

Neni 17

Ndalimi i shpërndarjes së fitimeve

IS është një organizatë jofitimprurëse. Ajo e ka të ndaluar shpërndarjen e fitimeve për anëtarët e tij dhe anëtarët e forumeve shkencore e administrative të tij.

Neni 18

Largimi dhe përjashtimi

Çdo anëtar i IS ka të drejtë të largohet nga organizata për çfarëdo lloj motivi. Ai, në rast largimi, ka pjesën e përgjegjësisë që i takon, lidhur me detyrimet dhe përgjegjësitë e organizatës kundrejt të tretëve, deri në çastin e largimit të tij. Përgjegjësia e anëtarit që largohet është e njëjtë me atë të anëtarëve të tjerë të organizatës, për veprimtarinë e kryer deri në çastin e largimit.

Përjashtimi nga IS është masa më ekstrme. Ai vendoset nga organi që miraton pranimin, për shkelje të rënda të statutit, disiplinës financiare, Kodit të Etikës ose për mospjesëmarrje të pajustificuara për një kohë të gjatë. Diskutimi për përjashtimin nga organizata bëhet një për një e jo me listë.

Neni 19 Ndryshimi i statutit

Ndryshimi i statutit të organizatës bëhet nga asambleja, me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të IS. Vendimi i mbledhjes së përgjithshme për ndryshimin e statutit, depozitohet në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, sipas procedurave të caktuara me ligj.

KREU III TË ARDHURAT DHE VEPRIMTARIA EKONOMIKE

Neni 20 Licensimi

IS, për realizimin ose mbështetjen e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së parashikuar në këtë statut, ka të drejtë të ushtrojë çfarëdo lloj veprimtarie të ligjshme. Kur ushtrimi i një veprimtarie paraprihet nga nevoja për marrjen e një leje ose licence, IS i paraqet kërkesë organit kompetent, për t'u pajisur me lejen a licencën përkatëse.

Neni 21 Burimet dhe përdorimi i të ardhurave

Burimet financiare të IS janë të ardhurat nga kuotizacioni, fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës IS, nëse do të ketë të tilla. Në rastet e pjesëmarrjes në projekte, çdo zë i të ardhurave dhe shpenzimeve parashikohet në to.

Në qoftë se IS siguron të ardhura nga burime që njihen nga ligji "Mbi OJF-të", shpenzimet do të bëhen vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë, apo për drejtimin e mirëmbajtjen e pasurisë së tyre.

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e organizatës prej personave që janë subjekte të këtij statuti ose aktit themelues, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të organizatës.

IS, në raste të veçanta, në përputhje me mundësitë financiare, mund t'u japë ndihmë financiare anëtarëve të tij, personave të jashtëm ose subjeteve të tjera. Ai mund të japë ndihma të tilla edhe nga fonde të dhuruara ose të vëna në dispozicion, kur donatorët kanë përcaktuar shprehimisht një të drejtë të tillë.

Neni 22 Veprimtaria ekonomike

IS, për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së tij, ka të drejtë të ushtrojë veprimtari ekonomike, siç parashikon ligji, pa qënë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e organizatës, të jetë e deklaruar si një nga burimet e të ardhurave, transparente dhe me kusht që kjo veprimtari të mos përbëjë qëllimin primar të veprimtarisë së IS.

Nëse IS, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, realizon fitime, ato duhet të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit dhe për asnjë destinacion tjetër.

Neni 23 **Mbledhja e fondeve**

IS ka të drejtë të kryejë veprimtari për mbledhjen e fondeve, për t'i përdorur për përmbushjen e qëllimeve dhe objektit të veprimtarisë së tij ose për të mbështetur qëllimet dhe veprimtaritë e organizatave të tjera jofitimprurëse, në përputhje me ligjet.

Neni 24 **Marrëdhëniet me donatorët**

Marrëdhëniet financiare, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse, por duke respektuar kërkesat e këtij statuti dhe ligjit mbi OJF-të.

IS shprehet sidomos për të mos lejuar asnjë ndihmë materiale ose financiare që jepet për qëllime të kundërligjshme dhe për të mos pranuar asnjë ndihmë që sigurohet nëpërmjet burimeve të kundërligjshme.

Neni 25 **Dhurimet dhe kontraktimet me organet shtetërore**

IS ka të drejtë të marrin pjesë, si të gjithë personat e tjerë juridikë, në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit dhe të prokurimit të granteve, të kontraktimeve dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve publike, të mallrave dhe të pasurive publike, si dhe të transferimit të shërbimeve publike dhe pasurive përkatëse nga sektori publik tek organizatat jofitimprurëse.

Neni 26 **Marrëdhëniet dhe detyrimet fiskale**

IS regjistrohet në organin taimor dhe paguar sigurimet shoqërore-shëndetësore për personat e punësuar në të. IS është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat që realizohen nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë, por paguan tatimin mbi të ardhurat personale, siç parashikon ligji.

Neni 27 **Pranimi i mbikëqyrjes**

IS njeh të drejtën që kanë organet kompetente shtetërore që të mbikëqyrin organizatat jofitimprurëse përsa i përket zbatimit të legjislacionit taimor, doganor, të sigurimeve shoqërore, të lejitimit të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, të kontraktimit të ushtrimit të shërbimeve publike e sociale, si dhe për përmbushjen e veprimtarive të tyre me fonde të Buxhetit të Shtetit.

KREU III VETËSHPËRNDARJA, LIKUIDIMI, MOSMARRËVESHJET

Neni 28

Në rast shpërbërje (me iniciativën e saj, ose me vendim të gjykatës), IS likuidohet në përputhje me ligjin. Ajo cakton tre likuidatorë, të cilët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetet, pasurinë dhe përfaqësimin e tij, që nga dita e emërimit të tyre dhe deri në përfundimin e likuidimit.

Likuidatorët bëjnë vlerësimin e gjendjes financiare të organizatës dhe të pasurisë së saj, në çastin e marrjes së vendimit për shërndarje, si dhe evidentojnë të gjithë kreditorët e debitorët e mundshëm.

Pas pagimit të detyrimeve që organizata i ka shtetit dhe kreditorëve të tjerë dhe marrjes së detyrimeve nga të tretët, likuidatorët vlerësojnë pasurinë e mbetur dhe kujdeset që kjo pasuri të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga organi kompetent i saj, gjykata ose ligji.

IS nuk pretendon që, në një rast të tillë, të ketë shpërndarje ose disponimi në favor të anëtarëve ose personave të tjerë që janë subjekte të këtij statuti ose të aktit të themelimit të tij, ose të të afërmeve të tyre.

IS angazhohet që për rastet kur ai ka përfituar përjashtim nga taksat apo lehtësira fiskale, donacione nga publiku ose grante shtetërore, çdo pasuri e mbetur pas pagimit të detyrimeve t'u shpërndahet organizatave të tjera jofitimprurëse që ndjekin qëllime të njëjta ose të ngjashme me të.

Në rastet kur IS shpërndahet vullnetarisht, përfituesit e pasurisë së mundshme të mbetur përcaktohen me një vendim të organit më të lartë vendimmarrës të tij. Në pamundësi vendimi, lihet në kompetencë të gjykatës.

Neni 29 Ç'regjistrimi

Kur shpërndarja është vendosur nga vetë IS, organi vendimmarrës, miraton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe kërkon nga gjykata çregjistrimin e tij. Në pamundësi kjo kompetencë i njihet gjykatës.

Neni 30 Zgjidhja e konfliktit të interesave

Çdo anëtar i organit më të lartë vendimmarrës ose ekzekutiv të IS duhet të tërhiqet nga shqyrtimi dhe marrja e vendimit për çdo çështje që ai ose familjarët e tij kanë interesa të drejtpërdrejta ose të tërthortë ekonomike ose vetjakë. Çdo transaksion financiar për llogari të IS, ndërmjet një anëtari të organit vendimmarrës, atij ekzekutiv a një punonjësi të organizatës, si dhe një personi tjetër juridik dhe fizik (kur anëtari i organit vendimmarrës, atij ekzekutiv ose punonjësi i organizatës jofitimprurëse ka interes financiar), mund të përfundojë vetëm nëse organi më i lartë vendimmarrës e lejon atë dhe nëse ky transaksion përmban kushte më të favorshme për organizatën jofitimprurëse.

Neni 31 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve IS, ndërmjet tyre dhe organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive, ose ndërmjet tyre dhe të punësuarve, zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me këtë statutin dhe rregullat e tjera të IS. Në të kundërt, çështja zgjidhet nga gjykata.

Neni 32

IS ka vulën, stemën dhe faqen e tij në internet: www.instituti-sociologjise.org në të cilën pasqyron me transparencë veprimtarinë e tij.



Instituti i Sociologjisë - IS
Albanian Institute of Sociology - AIS
Rr. Abdyl Frashëri, Pall. 3/3,
Tiranë
Tel & fax: ++ 355 (4) 268 819;
Mobile: ++ 355 (0) 692032731;
E-mail: lsokoli@instituti-sociologjise.org
Web site: www.instituti-sociologjise.org

PROGRAMI **i** **Shoqatës**

"INSTITUTI I SOCIOLOGJISË "

Hartues të këtij programi janë anëtarët themelues të shoqatës sociologjike "Instituti i Sociologjisë" (në vijim IS), si në listën bashkëngjitur.

IS krijohet dhe merr atributet e personit juridik pas regjistrimit në gjykatë, konform nenit 39 e vijues të K.C. të Republikës së Shqipërisë "Shoqatat, Krijimi i tyre" dhe ndryshimeve të bëra me ligjin Nr. 8781, datë 3. 05. 2001 dhe ligjin "Për Organizatat Jofitimprurëse", Nr. 8788, datë 7. 05. 2001.

IS e ka Selinë në Tiranë, do të ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, nëse krijohen mundësitë, edhe jashtë këtij territori.

IS nuk ka për qëllim fitime ekonomike si dhe ruan parimin e neutralitetit politik e fetar. Parimet udhëheqëse të IS janë: **puna në grup, anëtarësia, gjithëpërfshirja, vendimmarrja kolegjiale, hierarkia e vlerave shkencore** dhe e **kontributeve të tjera** (materiale, financiare etj.) të domosdoshme për zhvillimin e kërkimit shkencor sociologjik, **transparenca e veprimtarisë** dhe **komunikimi i hapur** (kryesisht në rrjet) midis anëtarëve. Në punën e vet hulumtuese, në kuadrin e IS, anëtarët e tij i përmbahen **parimit të rigorozitetit shkencor** akademik.

IS do të bashkërendojë, në mënyre ekskluzive, me shoqata sociologjike apo individuale, shqiptarë apo të huaj, që u nënshtrohen parimeve mbi bazën e të cilave do të ushtroje veprimtarinë e saj edhe IS.

IS synon:

Të nxisë zhvillimin e sociologjisë, të kordinojë dhe stimulojë veprimtarinë shkencore të studiuesve të kësaj fushe, të nxisë kërkimin dhe debatin shkencor akademik.

Të sensibilizojë opinionin publik shqiptar dhe institucionet e tjera të shtetit dhe shoqërisë për dukuri të ndryshme sociale dhe të sugjerojë rrugëzgjdhje me interes publik.

Të stimulojë krijimin e hierarkisë së vlerave dhe kontributeve, shkencore si dhe të sponsorizimit të kërkimit shkencor sociologjik.

Të bëhet një institucion me autoritet shkencor dhe i besueshëm në testimin e opinionit publik, duke iu përmbajtur rigorozitetit shkencor dhe duke aplikuar një metodologjie rigorozë të hulumtimit sociologjik.

Të krijojë një rrjet të kërkimit shkencor sociologjik në Shqipëri dhe ndër studiuesit shqiptarë, pavarësisht ku punojnë e jetojnë.

Të krijojë mundësi financimi të kërkimit shkencor sociologjik, përmes vullnetarizmit të anëtarëve dhe miqve të sociologjisë, sponsorizimeve, botimeve, shërbimeve, sipërmarrjes mbi baza ligjore, projekteve të financuara etj.

Të ndjekë dhe të nxisë përgatitjen e studiuesve të rinj të sociologjisë, përgatitjen e tyre në universitetet publike e jopublike, punësimin e tyre, kualifikimin shkencor pasuniversitar, përfshirjen në projekte etj.

Objekti i veprimtarisë së IS përfshin:

Studime shkencore në fushën e sociologjisë;

Veprimtari shkencore (simpoziume, seminare, konferenca, tryeza diskutimesh etj.), me tematikë sociologjike;

Leksione akademike e publike, mbi problemet sociale të shoqërisë, kurse afatshkurtëra e afatmesme trainimi për përgatitje profesionale e shkencore;

Bashkëpunim shkencor me universitete publike e jopublike, organizata, shoqata dhe institucione shqiptare e të huaja;

Botime librash, revistash etj., me karakter shkencor sociologjik, kryesisht sociologjik apo të shkencave të afërta me sociologjinë;

Veprimtari të ligjështme (ekonomike ose joekonomike) që gjeneron të ardhura, me kusht që ato, si dhe pasuritë e IS, të mos ndahen si fitime dhe të mos përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë statut.

Anëtarët e Shoqatës ndahen në kategoritë e mëposhteme: Anëtarë themelues, anëtarë të zakonshëm të degeve të krijuara në rrethe, anëtarë nderi dhe anëtarë korespondentë.

Organet e shoqatës janë: Mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve, Bordi Akademik dhe ai Ekzekutiv. Zgjedhja dhe veprimtaria e tyre parashikohet në statutin e IS.

Ushrimi i aktivitetit financiar të shoqatës, shrihet nga 1 Janari e deri më 31 dhjetor të çdo viti. Fondi i shoqatës përbehet nga kontributi fillestar, kuotat vjetore të anëtarësimit në shoqatë, ose nga fonde me origjinë tjetër. IS mund të marrë dhurime, nën çfardo forme, nga shoqëri, ente dhe institucione publike dhe private shqiptare apo të huaja, si dhe nga persona fizikë, të cilat pasi të jenë miratuar nga organi vendimmarrës, bëhen pjesë e pasurisë së IS dhe përdoren sipas nevojave, në përputhje me statutin.

Që të mund të kryesh detyra brenda shoqatës është e nevojshme të jesh anetar i saj. Për të shmangur konfliktin e interesave (veç siç është parashikuar në nenin 20 të statutit), nuk lejohet marrje persiper, nga i njejti person, i më shumë se një detyre në kuadrin e

shoqatës. Në rast mosperputhshmerie, i interesuari duhet të zgjedhë një nga detyrat që i janë caktuar. Autoriteti më i lartë shkencor i IS është Kryetari i Bordit Akademik. Parashikohet që ai të mos jetë titullar (përfaqësues ligjor) i një OJF-je tjetër shqiptare ose të huaj.

Shpërndarja e shoqatës behet në referim të ligjit. Në rast shpërndarjeje pasuria që mbetet, pasi të jenë paguar detyrimet e mundëshme, ndahet siç është parashikuar në Kreun III (neni 28 e në vijim) të statutit.

Shoqata “Instituti i Sociologjisë” ka vulën e tij, në të cilën është shkruar “Instituti i Sociologjisë” Tiranë-Shqipëri dhe, në anglisht, “Albanian Institute of Sociology”, Tirana-Albania.

.....